



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

26.02.2019

Për: Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës

Lënda: Thirrja për aplikime për financimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal

Të nderuar Kryetarë,

Bazuar në mandatin ligjor për avancimin e qeverisjes lokale në Kosovë, Ligji nr. 06/1-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka lansuar fondin për mbështetje financiare për komunat e Republikës së Kosovës, për realizimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal të infrastrukturës socio-ekonomike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët.

Fondi për bashkëpunim ndërkomunal është pjesë e buxhetit të MAPL-së, nga kategoria buxhetore - investime kapitale për vitin 2019 në vlerën prej 1,000,000.00 €, ndërsa kërkesat për financim nga buxheti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal do të financohen në vlerat prej 150,000.00 € deri 300,000.00 € euro dhe të gjitha propozimet e komunave partnere, buxheti i propozuar për projekte, duhet të jenë në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Fondi për bashkëpunim ndërkomunal ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal në realizimin e projekteve të përbashkëta të komunave që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik lokal dhe projekteve kapitale të dy a më shumë komunave, të bazuara në interesin e përbashkët lokal dhe vullnetin e lirë të komunave për të realizuar projekte të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkomunal.

Në mënyrë që të sigurojmë kohë të mjaftueshme për konsultimet dhe dakordimet paraprake nga komunat, MAPL ka përcaktuar afatin për aplikim nga data 26.02.2019 deri më 10.04. 2019 për përgatitjen e projekt - propozimeve nga dy a më shumë komuna partnere.

Bashkëngjitur gjeni thirrjen për aplikime për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal, e cila lansohet me datë 26.02.2019 dhe do të jetë e hapur deri më 10.04.2019.

Bashkëngjitur gjeni udhëzuesin për aplikim që ofron informata të detajuara lidhur me kriteret e përzgjedhjes, formën e aplikimit dhe udhëzime të tjera për projektet e bashkëpunimit ndërkomunal. Të njëjtin aplikacion bashkë me formularët për aplikim të projekteve, mund ta gjeni edhe në ueb-faqen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në linkun <https://mapl.rks-gov.net/shpallje-konkurse/thirrje-per-propozime/>.

Për të ofruar sa më shumë mundësi për komunat që të kenë në dispozicion të gjitha informatat për fondin për bashkëpunim ndërkomunal, në janar të vitit 2019, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të organizojë 5 seanca informuese në komuna.

Projekt-propozimet e komunave dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike në arkivin e MAPL-së, në ndërtesën e dytë qeveritare "Ish Pallati i Rilindjes, kati përdhese.

Për çdo sqarim dhe informatë shtesë lidhur me aplikimin, ju lutem kontaktojeni Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Sinqerisht,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje:

Kabinetit të Ministrit të MAPL-së
DBZHR/MAPL
Arkivi i MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

26.02.2019

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
THIRRJE PËR APLIKIM PËR PROJEKTE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Afati për aplikim: 26.02.2019 deri më 10.04.2019

Fondi për bashkëpunim ndërkomunal do ofrojë mundësi për komunat për të zhvilluar dhe promovuar bashkëpunimin ndërkomunal me projektet e përbashkëta të dy a më shumë komunave të Kosovës, të iniciuara në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave 03/L-041, Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr. 04/10, Rregulloren për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal Nr. 09/2013, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023.

HYRJE

Bashkëpunimi ndërkomunal në Republikën e Kosovës është rregulluar me aktin më të lartë juridik në vend, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr. 04/10, Rregulloren për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal Nr. 09/2013, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023.

Në këtë kontekst, në mbështetje të komunave të Kosovës për të ngritur efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, MAPL ka lansuar thirrjen për aplikim për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal që kanë për qëllim promovimin e bashkëpunimit ndërkomunal të komunave në realizimin e projekteve të përbashkëta të dy a më shumë komunave për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik lokal.

Fondi për bashkëpunim ndërkomunal është pjesë e buxhetit të MAPL-së, nga kategoria buxhetore - investime kapitale për vitin 2019 në vlerën prej 1,000,000.00 €, ndërsa kërkesat për financim nga buxheti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal do të financohen në vlerat prej 150,000.00 € deri 300,000.00 € euro dhe të gjitha propozimet e komunave partnere, buxheti i propozuar për projekte, duhet të jenë në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në mënyrë që komunat të jenë të njoftuara me të gjitha detajet për procedurat për aplikim për fondin për bashkëpunim ndërkomunal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përgatitur Udhëzuesin për Aplikim (pjesë e këtij dokumenti) që do të ofrojë të gjitha informatat e nevojshme për komunat lidhur me fondin e bashkëpunimit ndërkomunal.

Për të ofruar sa më shumë mundësi për komunat që të kenë në dispozicion të gjitha informatat e nevojshme për fondin për bashkëpunim ndërkomunal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të organizojë 5 seanca informuese në komuna, ku do të përfshihen të gjitha komunat e Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

26 shkurt 2019

UDHËZUESI PËR APLIKIM
FONDI PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL 2019

1. Objektivat e fondit për bashkëpunim ndërkomunal

- 1.2 Mbështetja financiare për projektet e bashkëpunimit ndërkomunal/ parimet;
- 1.3 Kriteret e financimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal;
- 1.4 Kriteret e përgjithshme të financimit projekteve për bashkëpunim ndërkomunal;
- 1.5 Kriteret e veçanta të përzgjedhjes së projekteve për bashkëpunim ndërkomunal;
- 1.6 Procedura e miratimit të iniciativave të komunave për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal, para aplikimit për projekte në MAPL;

2. Koordinimi i akterëve në mbarëvajtjen dhe monitorimin e projekteve

- 2.1 Buxheti dhe ndarja e roleve të komunave partnere për fondin e bashkëpunimit ndërkomunal;
- 2.2 Procedurat e prokurimit të projekteve për fondin e bashkëpunimit ndërkomunal;
- 2.3 Vlerësimi i projekteve për bashkëpunim ndërkomunal;
- 2.4 Afati (orari) për vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve të suksesshme të BNK-së

3. Dokumentet dhe format e aplikimit për fondin për bashkëpunim ndërkomunal

- 3.1 Aplikacioni për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal (Shtojca nr. 1);
- 3.2 Deklarata e partneritetit nga komuna për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal (Shtojca nr. 2);
- 3.3 Konfirmimi i pajtueshmërisë dhe vullnetit të komunave për realizimin e projektit (Shtojca nr. 3);
- 3.4 Nisma e miratuar nga Kuvendet e komunave për bashkëpunim ndërkomunal (Shtojca nr. 4);
- 3.5 Buxheti i planifikuar për aplikim për fonde të bashkëpunimit ndërkomunal (Shtojca Nr. 5);
- 3.6 Orari i organizimit të seancave informuese në Komuna për fondin e bashkëpunimit ndërkomunal (Shtojca nr. 6).

1. Objektivat e fondit për bashkëpunim ndërkomunal

Objektivat e fondit për bashkëpunim ndërkomunal janë të orientuara në promovimin e bashkëpunimit ndërkomunal të dy a më shumë komunave, për të realizuar projekte të përbashkëta, që kanë ndikim direkt në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët në fushën e shërbimeve publike komunale dhe të zhvillimit ekonomik lokal.

Objektivat e fondit për bashkëpunim ndërkomunal paraqesin bazën ligjore të projekteve të komunave të harmonizuara në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, 03/L-040, Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave 03/L-041, Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr. 04/10, Rregulloren për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal Nr. 09/2013, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023 të bazuara në:

- Forcimin e bashkëpunimit në mes të Komunave të Republikës së Kosovës për të ndërmarrë iniciativa për realizimin projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, duke shfrytëzuar dhe promovuar mundësitë ligjore të përcaktuara me Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr.04/10, dhe partneritetet mes komunave për realizuar projekte të përbashkëta.
- Promovimi i bashkëpunimit ndërkomunal mes dy a më shumë komunave në realizimin projekteve të përbashkëta që kanë ndikim direkt në zhvillim socio-ekonomik lokal, planifikim urban dhe rural, mbrojtje të mjedisit, promovim dhe zhvillim të turizmit, ruajtje të trashëgimisë kulturore që kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve.

1.2. Mbështetja financiare për projektet e bashkëpunimit ndërkomunal/parimet

Mbështetja financiare dhe administrative e komunave në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal, bazohet në parimet e financimit të orientuara në fushat që kanë rëndësi të veçantë për qytetarët e komunave, si në vijim:

1. Ligjshmëria - komunat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kornizës kushtetuese, ligjore, si dhe akteve tjera normative të Republikës së Kosovës.
2. Transparenca - komunat që kanë hyrë në bashkëpunim ndërkomunal janë të hapura ndaj institucioneve që ofrojnë përkrahje financiare dhe qytetarëve me rastin e hartimit të projekteve prioritare dhe zbatimit të tyre, për të rritur cilësinë shërbimeve publike dhe administrative, që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së qytetarëve.
3. Qëndrueshmëria – zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe programeve të përbashkëta ndërkomunale, për kohë të pacaktuar dhe me qëllim të realizimit të synimeve që

paraprakisht janë përcaktuar nga autoritetet komunale që janë pjesë e bashkëpunimit ndërkomunal.

4. Mirëbesimi-lidhja dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me besim reciprok në mes të komunave;

5. Interesi i përbashkët - komunat lidhin marrëveshje bashkëpunimi në fusha të caktuara administrative dhe teknike më qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta.

1.3. Kriteret e financimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal

Kriteret e financimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal, janë të ndara në kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të vlerësimit, që bazohen në vullnetin e lirë të dy a më shumë komunave në realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta për ushtrimin e kompetencave të komunave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, 03/L-040.

Varësisht nga projektet që adresohen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, komunat duhet të zhvillojnë një projekt konkret, me aktivitete konkrete duke u bazuar me një plan kohor për zbatimin e tyre. Pjesë e propozimit duhet të jetë: qëllimi i bashkëpunimit, objektivat, aktivitetet, ndarja e përgjegjësisë të komunave partnere në kuadër të BNK-së dhe buxheti i planifikuar për secilin aktivitet.

Të drejtë aplikimi për fondin për bashkëpunim ndërkomunal kanë vetëm Komunat e Republikës së Kosovës, të bazuara në kriteret në vijim:

1.4 Kriteret e përgjithshme të financimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal

1. Komuna duhet të propozoj projektin që është në pajtueshmëri me objektivat e fondit për bashkëpunim ndërkomunal;
2. Qëllimi i projekt-propozimit duhet të synojë përmbushjen e objektivave strategjike për vetëqeverisje lokale 2016-2026 dhe Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023;
3. Komunat duhet të përgatisin projektin ideor me një vlerësim paraprak të kostos së projektit;
4. Projekt propozimi duhet të dëshmoj interesin e përbashkët lokal të dy a më shumë komunave për të realizuar projektet e bashkëpunimit ndërkomunal;
5. Projekt propozimi për realizimin e projektit të përbashkët ndërkomunal, duhet të jetë Projekt i ri dhe nuk duhet të jetë vazhdimësi e ndonjë projekti tjetër.

1.5 Kriteret e veçanta të përzgjedhjes së projekteve për bashkëpunim ndërkomunal;

Të gjitha projektet e komunave për bashkëpunim ndërkomunal duhet të jenë të bazuara në kriteret e përcaktuara me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal nr. 09/2013.

1. Projekt-propozimet duhet të dëshmojnë iniciativat nga kryetarët të komunave partnere, të miratuara nga Kuvendet e Komunave dhe të vlerësuara ligjërisht nga Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal;
2. Projekt-propozimi duhet të dëshmojë projektin e orientuar në zhvillim socio - ekonomik lokal, planifikim urban dhe rural, mbrojtje të mjedisit, promovim dhe zhvillim të turizmit, ruajtje të trashëgimisë kulturore, të cilat janë të rëndësishme për qytetarët e Komunave;
3. Projekt - propozimi duhet të dëshmojë ndarjen e roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet komunave (caktimi i komunës lidere dhe partnere) si dhe bashkimin e interesave të komunave për nevoja të bashkëpunimit dhe përmirësimin e ekonomicitetit në ofrimin e shërbimeve komunale në dobi të qytetarëve;
4. Projekt-propozimi duhet dëshmojë dokumentacion pronësoro - juridik, të komunave partnere për parcelën/at ose lokalitetin ku do të realizohet projekti;
5. Projekt - propozimi duhet dëshmojë qëndrueshmërinë ekonomike të realizimit të projektit të bazuar në pritjet dhe jetëgjatësinë e projektit;
6. Projekt - propozimi duhet të dëshmojë deklaratën e partneritetit për bashkëfinancimin e projekteve të propozuara (në rast të aplikimit të projekteve për bashkëfinancim);
7. Projekt - propozimi duhet të dëshmojë ndarjen e roleve dhe përgjegjësiive midis komunave dhe bashkimin e resurseve komunale për nevojat e bashkëpunimit dhe ndarjen e roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet komunave në caktimin e komunës lidere dhe partnere.

1.6 Procedura e miratimit të iniciativave të komunave për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal para aplikimit për projekte ne MAPL

Është më rëndësi të ri-theksohet se baza fillestare e vlerësimit të projekteve të komunave është e bazuar në procesin e konsultimit dhe miratimit paraprak të nismave të dy a më shumë komunave për të aplikuar për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal sipas procedurave të përcaktuara më Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal nr. 04/10.

Pas përfundimit të konsultimeve dhe pajtimit në mes të komunave partnere për realizimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal, para dorëzimit të aplikacioneve

në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, secila nga komunat partnere duhet t'i zbatojë obligimet si në vijim:

- Iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal paraqitet për diskutim dhe aprovim nga Kryetari i Komunës në Kuvendin e Komunës me iniciativën apo propozimin në fjalë, përveç nëse nismën e ka parashtruar vet kryetari i komunës.
- Kuvendi i Komunës e shqyrton nismën e Kryetarit të Komunës, mban një seancë të hapur për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me nismën dhe merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës mbi nevojën e vendosjes së bashkëpunimit në pajtim me ligjin në fuqi.
- Nëse Kuvendi i Komunës e miraton nismën për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal, atëherë Kuvendi me vendim e autorizon Kryetarin e Komunës për t'i filluar konsultimet me komunat dhe palët e tjera për përgatitjen e propozim-marrëveshjes për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal.
- Nismat për bashkëpunim ndërkomunal duhet të përmbajnë: Qëllimin e bashkëpunimit; Kompetencat që kanë të bëjnë me BNK për komunat e përfshira në bashkëpunim; Formën e bashkëpunimit; Përfitimet e pritura; 5. Implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi; Çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e BNK, të cilat duhet të jenë të njohura për institucionet dhe qytetarët e komunave përkatëse. (Shtojca nr. 2)

2. Koordinimi i akterëve në mbarëvajtjen dhe monitorimin e projekteve

Procesi i mbarëvajtjes së projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal të komunave, të realizuar nga fondi për bashkëpunim ndërkomunal do të koordinohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunat e Republikës së Kosovës.

Komunat partnere të projektit, do të themelojnë një grup punues për zbatimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal në përbërje të zyrtarëve të komunave partnere që kanë iniciuar projektin për bashkëpunimin ndërkomunal.

Grupi punues do të organizojë takime të rregullta me përfshirje të gjithë akterëve në projekt të bashkëpunimit ndërkomunal dhe do përgatis raporte periodike lidhur me mbarëvajtjen e projekteve nga informatat e siguruar nga monitorimi i projekteve në teren.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të monitorojë projektet e bashkëpunimit ndërkomunal dhe do të caktohet një zyrtar përgjegjës që do të jetë në dispozicion të komunave për të ofruar informatat e nevojshme dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e projektit.

Komunat partnere që do të hynë në Marrëveshje për realizimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal janë të obliguara të raportojnë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në baza javore lidhur me mbarëvajtjen e realizimit të projektit.

2.1 Buxheti dhe ndarja e roleve të komunave partnere për fondin e BNK-së

Propozimi i menaxhimit të financave, do të jetë pjesa më e rëndësishme që duhet të diskutohet në fillim të inicimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe secili aplikacion nga komunat duhet të ketë draft buxhetin e listuar në secilin aktivitet të projektit.

Fondi i MAPL-së për bashkëpunim ndërkomunal, është i dedikuar në mënyrë specifike për projekte të dy a më shumë komunave dhe buxheti i projektit duhet të jetë i paraqitur qartë. Në rastet kur komunat partnere aplikojnë për projekte në bashkëfinancim, propozimi i buxhetit duhet të përcaktojë saktë obligimet financiare të komunave partnere që kanë ndërmarrë iniciativë për të aplikuar për fondin për bashkëpunim ndërkomunal.

2.2 Procedurat e prokurimit për projektet bashkëpunimit ndërkomunal

Bartësit e procedurave të prokurimit për projektet e bashkëpunimit ndërkomunal do të jenë Komunat, varësisht nga iniciativat e komunave, njëra nga komunat partnere të projektit do të caktohet lidere e udhëheqjes së procedurave të prokurimit, e cila do të specifikohet edhe në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunave partnere që do të nënshkruajnë marrëveshje për realizimin e projektit për bashkëpunim ndërkomunal.

2.3 Vlerësimi i projekteve për bashkëpunim ndërkomunal

Pas përfundimit të afatit të aplikimit nga komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të caktojë komisionin e vlerësimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal. Baza e vlerësimit të projekteve të suksesshme do të jenë projektet, të cilat janë iniciuar konform procedurave ligjore të përcaktuara me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal nr. 04/10, që ofrojnë projekte dhe rezultate të pritshme që do të realizohen nga dy a më shumë komuna partnere.

Gjatë procesit të vlerësimit të propozimeve të komunave, komisioni i vlerësimit të projekteve për bashkëpunim ndërkomunal, mund të kërkojë nga komunat informata shtesë lidhur me propozimet e dërguara në MAPL.

Projektet të cilat nuk kanë përfunduar fazën konsultimit paraprak, të ofrimit të dëshmive të miratimit të iniciativës së kryetarëve të Komunave nga Kuvendet e Komunave dhe konfirmimin e vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL, nuk do të merren në konsideratë në procesin e mëtejme të vlerësimit.

Pas përfundimit të vlerësimit të propozimeve të Komunave nga Komisionet për zgjedhjen e projekteve në MAPL, Komunitat të cilat kanë aplikuar për projekte për bashkëpunim ndërkomunal do të informohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për përzgjedhjen apo mospërzgjedhjen e tyre.

Pas përfundimit të fazës së vlerësimit të projekteve dhe shpalljen e komunave fituese, për komunitat të cilat kanë kaluar me sukses procesin e përzgjedhjes së projekteve, do të përgatiten Marrëveshjet e Mirëkuptimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Shtojca nr 1. Aplikacioni për projekt të bashkëpunimit ndër komunal të dy a më shumë komunave partnere



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Fondi për bashkëpunim ndërkomunal në Komunat e Republikës së Kosovës

Logot e komunave partnere

Formulari për Aplikim

I. APLIKUESI DHE PARTNERI(ET) E TIJ

Komunat partnere (aplikuese) për fondin për bashkëpunim ndërkomunal

Detajet kontaktuese të Komunës (lidere):

Kryetari:

Emri:

Telefoni:

Adresa:

Email adresa:

Personi përgjegjës për këtë projekt

Emri:

Pozita:

Drejtoria:

Telefoni:

Adresa:

Email adresa:

II. Komuna(at) Partnere:

Detajet e kontaktit për Komunën (at) Partnere:

Kryetari:

Emri

Telefoni:

Adresa:

Email Adresa:

Personi përgjegjës për këtë projekte

Emri:

Pozita:

Drejtoria:

Telefoni:

Adresa:

Emri dhe mbiemri

Pozita

Email adresa:

Përshkrimi i projektit

Qëllimi i projektit (së paku 100 fjalë)	
Aktivitetet e projektit	
Të priturat (përfitimet nga projekti) nga projekti (së paku 100 fjalë)	
Numri i komunave të përfshira në projekt	
Roli i komunave - përfshirja në implementimin e projektit	
Komuna lidere	
Komunat partnere	
Kostoja e projektit	

Data, maji, viti

Shtojca nr 2. Deklarata e partneritetit nga komuna për projekte të bashkëpunimit ndërkomunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Deklarata e partneritetit në mes të komunave

Komunat partnere pajtohen me përmbajtjen e projekt - propozimit që do të aplikojmë për projekt nga fondi i MAPL për bashkëpunim ndërkomunal. Zotohemi se do të marrim përsipër të gjitha obligimet e përcaktuara nga shkresa e MAPL-së dhe Udhëzuesi për aplikim për bashkëpunim nderkomunal.

Emri dhe mbiemri i kryetarit të komunës lidere	
Komuna	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data dhe Vendi	

Përshkrim i shkurtër i projektit (minimumi 100 fjalë)

Shtojca nr 3. Konfirmimi i pajtueshmërisë dhe vullnetit të komunave për realizimin e projektit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Logo e Komunave partnere

Konfirmimi i pajtueshmërisë dhe vullnetit të komunave për realizimin e projektit

Ne garantojmë përkushtimin e komunës dhe stafit të komunës për zbatimin e projektit. Ne po ashtu garantojmë se komuna do të përmbushë të gjitha obligimet siç na udhëzon formulari për bashkëpunim ndërkomunal. Në kopje të formularit për aplikim gjeni:

- 1) Iniciativat e aprovuara nga Kuvendet e Komunave për fondin për bashkëpunim ndërkomunal
- 2) Vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- 3) Buxhetin e planifikuar për aplikim për fonde të bashkëpunimit ndërkomunal

Komuna Lidere

Kryetari

Komunat partnere

Kryetarët

Data, maji, viti

Shtojca nr.4 Iniciativa për Bashkëpunim Ndërkomunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, **Kryetari i Komunës** paraqet kërkesë për miratimin:

NISMËN
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN/AT
NË FUSHËN _____

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me komunën/komunat si në vijim:

1.1. Komunës së _____,

1.2. Komunës së _____,

2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën _____, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e _____.

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.

3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës.

4. **Arsyetimi** -

02. Nr. _____ Komuna, _____ Kryetari i Komunës _____

Shtojca nr.5 Buxheti i planifikuar për aplikim për fonde të bashkëpunimit ndërkomunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Buxheti i planifikuar për aplikim për fonde të bashkëpunimit ndër komunal

Buxheti total i projektit	Shuma
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Shuma
Komuna lidere	Shuma
Komuna/t partnere	Shuma



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ndërtesa e Qeverisë "ish-Rilindja"
Kati: XI, XII, XIII
Email: info.mapl@rks-gov.net
Tel: +383 (0) 38 200 35 567
+383 (0) 38 200 35 598
+383 (0) 38 200 35 577